R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2110/4 prot. Tiranë, më 12.10.2026

V E N D I M

Nr. 41, datë 12.10.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Ankuesi, z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 2110 prot., datë 27.07.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Urdhri i Psikologut" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 24.06.2026, depozituar në adresën elektronike sekretaria@urdhripsikologut.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Vendimet e Këshillit Kombëtar, konkretisht:*

   - *vendimi nr. 5, datë 24.02.2026;*
   - *vendimi nr. 6, datë 03.03.2026;*
   - *vendimi nr. 7, datë 03.03.2026;*
   - *vendimi nr. 8, datë 22.04.2026;*
   - *vendimi nr. 9, datë 03.06.2026;*
   - *vendimi nr. 10, datë 03.06.2026;*
   - *vendimi nr. 11, datë 03.06.2026.*

   Për secilin nga vendimet e mësipërme kërkoj:

   - *Rezultatin e votimit (numrin e votave pro, kundër dhe abstenim);*
   - *Emrat e anëtarëve që kanë votuar pro, kundër ose kanë abstenuar;*
   - *Procesverbalin e mbledhjeve.*

2. *Statusin aktual të ankesës nr. 472 prot., datë 24.06.2026, depozituar pranë Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional.*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 2110 prot., datë 27.07.2026, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 2110/1 prot., datë 07.08.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 14.08.2026.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 543/1 prot., datë 14.08.2026, protokolluar me nr. 2110/2 prot., datë 17.08.2026, i ka kthyer përgjigje Zyrës së Komisionerit dhe ankuesit, duke informuar se: *"...Urdhri i Psikologut e ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe po vijon me verifikimin e dokumentacionit përkatës. Për shkak të pushimeve vjetore dhe reduktimit të stafit gjatë kësaj periudhe, përfundimi i verifikimeve dhe përgatitja e një përgjigjeje të plotë kërkon pak më shumë kohë... Për sa i përket kërkesës së z. Nika lidhur me ankimin e drejtuar pranë Komisionit të Gjykimit Etik dhe Disiplinor Profesional, dëshirojmë të sqarojmë se informacioni përkatës i është përcjellë tashmë z. Nika, nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 353 prot., datë 06.08.2026..."*.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të *email*-it të datës 17.08.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2110/3 prot., datë 18.08.2026, ka vijuar ankimin e tij.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, Urdhri i Psikologut

është autoritet publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike"*.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 6, kryesisht nenit 7 të LDI-së, i cili parashikon se: "*1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër ... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;... 3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike. 4. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni publikohet i përditësuar në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit, sipas mënyrës së përcaktuar nga Komisioneri*", vendimet e kërkuara me anë të kërkesës datë 24.06.2026 duhet të ishin publikuar në mënyrë proaktive nga ana e Autoritetit Publik.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, duhet bërë dallimi ndërmjet vendimeve të Këshillit Kombëtar, si akte përfundimtare të Autoritetit Publik, dhe informacionit/dokumentacionit tjetër të kërkuar nga ankuesi lidhur me procesin e vendimmarrjes, konkretisht rezultatin e votimit, votimin individual të anëtarëve dhe procesverbalet e mbledhjeve.

Për vendimet e Këshillit Kombëtar, detyrimi për publikimin e tyre në mënyrë proaktive duhet të vlerësohet në raport me kategoritë e informacionit, të parashikuara në nenin 7 të LDI-së dhe Programin e Transparencës të Autoritetit Publik.

Ndërsa për rezultatin e votimit, votimin individual të anëtarëve dhe procesverbalet e mbledhjeve, detyrimi për publikim proaktiv nuk rrjedh automatikisht nga detyrimi për publikimin e aktit përfundimtar. Këto kategori informacioni duhet të vlerësohen në kuadër të kërkesës për informacion, për aq sa prodhohen ose mbahen nga Autoriteti Publik, dhe aksesi në to nuk është subjekt i kufizimeve të parashikuara nga LDI ose legjislacioni i posaçëm.

Për rrjedhojë, fakti që një pjesë e informacionit të kërkuar mund të jetë objekt i publikimit proaktiv nuk përjashton detyrimin e Autoritetit Publik për të shqyrtuar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të plotë kërkesës për informacion për të gjitha kategoritë e informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, bazuar në nenet 31, 32, 33 dhe 34 të Statutit të Urdhrit të Psikologut, miratuar me vendimin nr. 1, datë 30.06.2017, të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, parashikohet shprehimisht se vendimmarrja e Urdhrit, procesverbalet e mbledhjeve dhe forma e votimit merren në formë të hapur, përveç rasteve kur, për arsye e rrethana të veçanta, me propozim të Presidentit, vendoset ndryshe. Në këto kushte, për vlerësimin e plotë të kërkesës për informacion, duhet të përcaktohet nëse për secilin prej vendimeve objekt të kërkesës votimi është zhvilluar në formë të hapur apo është vendosur ndryshe, si dhe nëse dokumentacioni i prodhuar ose i mbajtur nga Autoriteti Publik evidenton rezultatin e votimit dhe votën individuale të anëtarëve.

Nga ana tjetër, Autoriteti Publik, në kthim përgjigjen e datës 14.08.2026, nuk ka sqaruar ankuesin apo Zyrën e Komisionerit nëse ndodhemi përpara ndonjë prej kufizimeve të parashikuara nga neni 17 i LDI-së apo nga legjislacioni specifik dhe as ka dhënë një vlerësim të diferencuar për kategoritë e informacionit të kërkuar nga ankuesi.

Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Në lidhje me pikën 2 të ankesës nr. 2110 prot., datë 27.07.2026, Autoriteti Publik parashtron se nëpërmjet shkresës nr. 353, datë 06.08.2026, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke u përmbushur detyrimi për këtë pikë të kërkesës. Sidoqoftë, nga analiza e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atij specifik, Komisioneri vëren se kërkimi i pikës 2 të ankesës përbën një nga rastet e kufizimit të parashikuar nga neni 17 i LDI-së, përkatësisht shkronjën "c" të pikës 2 të tij, në të cilën parashikohet se: *"E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ...c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor...".*

Legjislacioni i mësipërm përforcohet edhe nga neni 13 e vijues i "Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional", shprehimisht nga pika 10 e nenit 17, e cila parashikon se: *"Në asnjë rast dokumentacioni i depozituar në dosje nuk mund të nxirret jashtë*

ambienteve të Urdhrit, të fotokopjohet, të riprodhohet apo të bëhet publik nga anëtarët e Komisionit".

Për sa më sipër, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në pikën 2 të ankesës mund t'i jepet vetëm palëve të interesuara në procesin administrativ, i cili po zhvillohet nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë, pika 3 e nenit 3 të LDI-së parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës dhe LDI, kërkon që Autoriteti Publik të shqyrtojë konkretisht informacionin e kërkuar dhe, kur pretendon ekzistencën e një kufizimi, të identifikojë bazën ligjore dhe kushtet që justifikojnë zbatimin e tij.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së z. , me nr. 2110 prot., datë 27.07.2026, ndaj Autoritetit Publik "Urdhri i Psikologut", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit, sipas kërkesës datë 24.06.2026, konkretisht: *"1. Vendimet e Këshillit Kombëtar: vendimi nr. 5, datë 24.02.2026; vendimi nr. 6, datë 03.03.2026; vendimi nr. 7, datë 03.03.2026; vendimi nr. 8, datë 22.04.2026; vendimi nr. 9, datë 03.06.2026; vendimi nr. 10, datë 03.06.2026; vendimi nr. 11, datë 03.06.2026. Për secilin nga vendimet e mësipërme kërkoj: Rezultatin e votimit (numrin e votave pro, kundër dhe abstenim); Emrat e anëtarëve që kanë votuar pro, kundër ose kanë abstenuar; Procesverbalin e mbledhjeve*", brenda datës 20.10.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

3. Rrëzimin e ankesës së z. , me nr. 2110 prot., datë 27.07.2026, ndaj Autoritetit Publik "Urdhri i Psikologut", për sa i përket pikës së dytë të kërkesës për informacion, datë 24.06.2026.

4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 12.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi